

PROF.ASSOC.DR.HELGA VUKAJ



Drejtor i Përgjithshëm, KLSH

Lindur ne 1978.

Diplomuar në Jurisprudencë(2000). Doktor i Shkencave Juridike.

10 vite eksperience pune. Juriste në Presidencë, Drejtor Drejtorie në Ministri të Brendeshme, zv drejtor i Përgjithshëm në Agjensinë e Kthimit dhe Kompesimit te pronave, 2 vitet e fundit në KLSH si Drejtoreshë e Përgjithshme.

Fusha e ekspertizës: Juris-Prudencia (pronat e paluajtshme).

ZHVILLIMET LIGJORE FORCOJNË KLSHⁱ

*nga Prof. Asoc. Dr. Helga Vukaj**

Detyrimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit është që të zhvillojë një veprimtari në bazë e në përputhje me Kushtetutën, pra të kryejë një proces të Auditimit të jashtëm publik vetëm ligjor, objektiv, të paanshëm, transparent, si dhe profesional.

I vetëdijshëm për këtë detyrim, KLSH pritet të sigurojë përfaqje e përputhshmëri tërësore edhe me veprimtarinë e homologëve tij, por jo vetëm, pse ai, në kuadër të anës procedimore, respekton edhe standardet ndërkombëtare. Nevoja për auditim dhe procesi auditues duhet të nxiten jo vetëm nga ligji, por edhe nga një prej parimeve themelore të Kushtetutës, interesi publik. Vetëm kur aktorët e auditimit të jashtëm publik të përsosin konceptin dhe të respektojnë vlerën e këtij parimi të rëndësishëm, prevalent ndaj shumë parimeve të tjera, atëherë sfida për përmbushjen me sukses të këtij misioni kompleks do të jetë e suksesshme. Pikërisht edhe për këtë arsye,

e me qëllim përmbushjen me sukses të sfidave në të ardhmen, KLSH inicioi forcimin e procesit ligjor, përmes disa amendimeve ligjore që synojnë zgjerimin e mandatit auditues dhe përputhjen e plotë me standardet ndërkombëtare të fushës, INTOSAI ligjin tonë organik. Këto amendime sjellin një konceptim bashkëkohor, si simotrat e tij evropiane, të të drejtave dhe detyrave të KLSH. Ato do të ndihmojnë në rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të institucionit; në shtimin e kapaciteteve administrative, saktësimin e së drejtës që KLSH të auditojë fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë deri tek përdoruesi i fundit dhe saktësimin e së drejtës që të çertifikojë llogaritë financiare të njësive të audituara. Amendimet forcojnë pavarësinë funksionale, duke e shndërruar KLSH në një strukturë tërësisht të integruar dhe në përputhje me standardet e veprimit të institucioneve homologe të vendeve të Bashkimit Evropian, si dhe mundësojnë që të kemi Auditues Publikë (të jashtëm) të çertifikuar.

Gjithashtu, për të arritur qëllimin kushtetues të një institucioni të pavarur, të specializuar e të konsoliduar në përmbushje të misionit të tij për auditimin e jashtëm të veprimitarisë ekonomiko-financiare, KLSH do të përsosë procedimin hetimor administrativ, duke iu përkushtuar parimit të ligjshmërisë, parimit të barazisë dhe proporcionalitetit, parimit të drejtësisë dhe paanësisë, bashkëpunimit me administratën, parimit të përgjegjshmërisë, parimit të eficiencës dhe deburokratizimit, parimit të mbrojtjes së sekretit shtetëror dhe konfidencialitetit dhe pa dyshim të drejtën për të informuar pjesëmarrësit në procedim.

Duke qenë se veprimtaria e KLSH duhet të jetë në përputhje edhe me Deklaratën e Limës, Standardet e Auditimit të INTOSAI-t dhe praktikat më të mira Evropiane, lind e nevojshme që paralelisht të ketë sinkronizim me detyrimet ligjore të lartpërmendura. Synimi për përmirësim të sistemit procedimor në formatin më të mirë tekniko-legjislativ do të jetë garanti i

ushtrimit të detyrës së gjithsecilit auditues, në përputhje me kompetencat e tagrat ligjorë të KLSH.

Praktika ka dëshmuar se ndërhyrja në këtë pikë është e domosdoshme dhe për rrjedhojë e dobishme, pasi saktësimi, qartësia e konkretizimi, nënkupton garanci ligjore e administrative të aktit administrativ (vendimin), pra vlerë të aktit. Kjo iniciativë përkon njëherësh me qëllimin për sintetizim dhe integrim të shumë akteve në një akt specifik/organik dhe eliminimin e kompleksitetit të referencave. Natyrisht kjo iniciativë do të ndikojë jo vetëm në lehtësimin e procedurave të auditimit, por edhe në zbatimin e detyrimit për të qenë transparent me subjektet e audituara dhe me mbarë publikun.

Pikërisht për të arritur ç'ka synon më sipër, institucioni ka marrë një iniciativë ligjore dhe ka qartësuar saktësisht atributet e veta, kompetencat dhe kufijtë e shtrirjes së tyre, me qëllim mos mbivendosjen as në koncept dhe as në veprimtari me auditimin e brendshëm dhe njëherësh as me pozitat e tyre administrative (auditimi i brendshëm është instrument administrativ varësie i Ministrisë së Financave dhe nuk mund të barazohet me auditimin e jashtëm). Gjithashtu, në funksion të auditimit të jashtëm dhe në përputhje me Kushtetutën, ku çdo rekomandim i shërben vetëm përmirësimit dhe rregullimit vijues, nevojitet që çdo përfitues të respektojë pozitivisht atë çka synohet përmes akteve të KLSH, pasi në të kundërt efekti për të qenë përmbushës të një misioni fisnik do të humbte sens.

Me rëndësi, në përmbushje të detyrimeve të tij ligjore, konsiderohet edhe përkufizimi dhe qartësimi i termit subjekte të audituara, si domosdoshmëri dhe garanci jo vetëm për procesin e auditimit të jashtëm, i parë nën optikën kushtetuese si një detyrim për dijeni (shpesh institucioni has vështirësi në marrjen dijeni ose informacion nga subjektet) e kontroll ndaj çdo qindarke publike të shpërndare apo të gjeneruar, por edhe për procesin auditues në

këndëvshtrimin e një procedimi unik administrativ (parimi i ligjshmërisë, të jemi kompetentë, të legjitimuar e të ligjshëm).

Gjithashtu duke iu referuar asaj që homologët e KLSH kanë në fokusin e veprimtarisë së tyre, auditimi i efikasitetit të përdorimit të financave apo asetëve ekonomike, efektiviteti dhe ekonomicitetit, pasqyrimi i qartë dhe jo nënkuptimi apo lënia për interpretim e konkluzioneve apo fakteve, ka një rëndësi të madhe për pozitën e procesit auditues në të ardhmen. Të gjithë ne e dimë se prona publike nuk mund të tjetërsohet, por duhet të mbrohet, të përmirësohet, t'i shërbejë publikut dhe nuk mund t'i ndryshohet destinacioni në emër të interesit privat. Një nga shembujt që mund t'i referohemi me impakt negativ në drejtim të pronës publike është dëmtimi urban i saj; një tjetër shembull është ai i keqadministrimit nga segmentet shtetërore të amortizuara, si psh Drejtoritë e shërbimit pyjor, Drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës, ZRPP, njësitë e qeverisjes vendore të cilat në kuadër të një menaxhimi jo të mirë tjetërsojnë statusin e saj, zërin kadastral, shkallën e mbrojtjes dhe në fund destinacionin dhe regjimin juridik, kjo është shumë e rrezikshme dhe me pasoja të rënda në ekonominë e vendit dhe interesin publik.

Për shkak të pozitave kushtetuese të KLSH, rëndësisë dhe vështirësisë së misionit të saj për të garantuar përputhshmëri, ligjshmëri, rregullshmëri, mirëmenaxhim financiar dhe ekonomicitet, efektivitet si dhe efikasitet në administrimin e fondeve dhe të pronës publike dhe shtetërore, nevojitet që e gjithë kjo të ketë suport të gjithanshëm administrativo-ligjor. Pra, të ketë bashkëpunim dhe sens pozitiv ndaj çdo zbulimi e rekomandimi duke i vlerësuar në mënyre moderne, të hapur, largpamëse e pa komplekse të drejtat dhe detyrat e KLSH.

Konceptimi modern i të drejtave dhe detyrave të KLSH, konsiston tek forcimi i marrëdhënieve të KLSH me Kuvendin, tek e drejta e komentimit

të projekt-legjislacionit ekonomik e financiar të përgatitur nga Qeveria, të udhëheqja metodologjike dhe vlerësimi i punës së auditimit të brendshëm si dhe vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik. Ai po ashtu konsiston tek pranimi dhe rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH nëpërmjet, institucionalizimit të marrëdhënieve të KLSH me subjektet e sektorit publik të audituara, për të bërë të mundur ndjekjen sistematike të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga KLSH dhe konsolidimin e institucionalizimin e marrëdhënieve me organet e drejtësisë, veçanërisht me organet e Prokurorisë, auditimin e brendshëm, inspektimin financiar etj., për arritjen e rezultateve të synuara në parandalimin e korrupsionit në sektorin publik.

Respektimi i Kodit të Procedurave Administrative dhe çdo detyrimi prej tij për një inicim procedimor të sigurt dhe një hetim administrativ të shëndoshë, është dhe mbetet sfidë e KLSH. Të verifikosh legjitimitetin, juridiksionin, kompetencën, subjektin, afatet, formën dhe përmbajtjen e aktit final dëshmon jo vetëm për prezencë profesionalistësh në auditimin e jashtëm suprem publik, por edhe për seriozitet e ligjshmëri të veprimtarisë audituese të kryer.

ⁱ Botuar në Gazetën “Metropol”, 13 maj, 2013